

*„Ndërto ura, jo mure: Roli i universiteteve në ndërtimin e paqes”*

## **Studimi: Të kuptuarit ndërkulturor dhe të drejtat e njeriut**

### **Qëllimi i programit është:**

- Që me njohuritë bazë të mirëkuptimit ndërkulturor të të drejtave të njeriut dhe zgjidhjes paqësore të konflikteve, si pjesë integrale e arsimit profesional, grupet relevante<sup>1</sup> profesionale në Kosovë të bëhen promotorë të këtyre vlerave në vendet e ardhshme të punës;
- T'i ndërtojë kompetencat e universiteteve/fakulteteve, që të jenë në gjendje t'i edukojnë nxënësit në një mënyrë që do të kontribuojë në zhvillimin e kulturës demokratike të bazuar në vlerat e përmendura më lart;
- Bashkëpunimi mes universiteteve në Kosovë, Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë.

### **Rezultatet e pritura:**

Pritet që pjesëmarrësit do të:

- Arrijnë të kuptojnë dhe të depërtojnë në mirëkuptimin ndërkulturor, të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen paqësore të konfliktit;
- Të jenë të aftë për të vepruar në përmirësimin e mirëkuptimit ndërkulturor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, bashkësinë ndërkombëtare dhe jetën e tyre;
- Fitojnë njohuri dhe shkathtësi që do t'iu ndihmojnë atyre të marrin pjesë në jetën e komunitetit multikulturor në mënyrë aktive dhe pozitive;
- Fitojnë njohuri teorike mbi natyrën empirike dhe normative të individëve në komunitetin dhe situatat multikulture, si dhe për bashkëjetesën me njerëz që kanë vlera, zakone dhe tradita të ndryshme;
- Fitojnë mirëkuptim në konflikte dhe në zgjidhjen e konfliktit në planin global, shtetëror, lokal e personal dhe drejtësinë tranzicionale;

---

<sup>1</sup> Grupet relevante profesionale janë profesionistë të ardhshëm, të cilët do të ndikojnë në gjendjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Kosovë. Kjo do të thotë mësues, hulumtime, punëtorë shëndetësorë, policë etj.

-Fitojnë aftësi në menaxhimin e konfliktit dhe të jenë të gatshëm për zgjidhje paqësore të konflikteve;

-Jenë kompetentë për t'i transferuar njohuritë dhe shkathhtësitë e fituara në ambientet e tyre personale dhe profesionale;

-Depërtojnë në metodat aktive, si një qasje e re në arsim në temat e përmendura më lart dhe të fitojnë shkathhtësi për praktikën e tyre në arsimin formal dhe joformal.